

Prot. 2211/223 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: Partia Republikane

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin PR, KRIIK ka konstatuar se:*

- partia ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;

- 1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;

- mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve.

Lidhur me Shpenzimet e partisë në Facebook dhe Instagram

Partia Republikane ka deklaruar 0 shpenzime për Facebook dhe Instagram, por rezulton që të ketë paguar shumë 342.668 lekë. Megjithatë, në raportin e kandidatit të saj z. Fatmir Mediu, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i saj, është deklaruar shpenzimi 309.208 lekë në zërin media sociale.

Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të PR për reklamë politike në Facebook dhe Instagram

Kandidati i PR z. Ferdinand Çobo, për faqen në Facebook të të cilit është paguar një shumë që është e pamundur për t'u indentifikuar saktësisht për shkak se është më e vogël se 100\$, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se PR nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “Deklarimi dhe publikimi” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania